

i FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

PERTUSINE

Shurup - (120 mg + 10 mg) / g
(Ekstrakt fluid timusi, Bromur kaliumi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ja rekomandoni personave të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues do të lexoni:

1. Çfarë është Pertusine dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Pertusine
3. Si ta merrni Pertusine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Pertusine
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PERTUSINE DHE PËRSE PËRDORET

Pertusine përmban lëndët vepruese bromur kaliumi dhe ekstrakt fluid timusi. Bromuri i kaliumit është një sedativ i lehtë dhe një hipnotik i lehtë. Ekstrakti fluid i timusit ka veprim ekspektorant dhe antillogjistik. Ai pakëson refleksat e kollës, favorizon ekspektorimin, zbut mukozën e inflamuar dhe qetëson kollën. Timoli, esenca e ekstraktit të timusit është një lëndë me veti ekspektorante dhe dezinfektuese në nivelin e rrugëve të frymëmarrjes. Bromuri i kaliumit është një lëndë e njohur për vetitë sedative të qendrës së kollës.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PERTUSINE

Mos merrni Pertusine në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri të njohur ndaj përbërësve të shurupit apo bimëve të tjera të familjes Lamiaceae (Labiatae);
- vuani nga atake astme;
- keni shqetësime ventilimi;
- vuani nga diabeti, për shkak të përmbajtjes së lartë të sheqerit në shurup.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos merrni Pertusine. Konsultohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna prej tij.

Tregoni kujdes të veçantë me Pertusine

Njoftoni mjekun tuaj në rast se vuani nga:

- insuficienca respiratore;
- astma.

Nëse shfaqet dispne, temperaturë apo sputum purulent, duhet të konsultohet mjeku.

Nëse simptomat përkeqësohen gjatë përdorimit të shurupit, duhet të konsultohet mjeku.

Pertusine përmban alkool etilik (etanol 96%), prandaj duhet treguar kujdes në gratë shtatzëna ose që ushqejnë fëmijën me gji, fëmijët dhe pacientët me risk të lartë, si p.sh. ata me sëmundje të mëlçisë ose epilepsi. Alkooli etilik (etanol 96%) është i dëmshëm për personat që vuajnë nga alkoolizmi.

Marrja e barnave të tjera

Nuk ka të dhëna nëse Pertusine mund të ndërveprojë me barna të tjera.

Shtatzënia dhe Ushqimi me gji

Për shkak të të dhënave të pamjaftueshme mbi sigurinë, nuk rekomandohet përdorimi.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Pertusine

Pertusine përmban:

- metilhidroksibenzoat, që mund të shkaktojë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara);
- sukrozë; nëse keni intolerancë ndaj disa sheqernave, kontaktini mjekun përpara se të merrni këtë bar. Duhet të merret parasysh nga pacientët me diabet të sheqerit;
- etanol (alkool); etanoli është i dëmshëm për personat që vuajnë nga alkoolizmi. Duhet të merret në konsideratë në gratë shtatzëna ose që ushqejnë fëmijën me gji, fëmijët dhe pacientët me risk të lartë, si ata me sëmundje të mëlçisë ose epilepsi.

3. SI TA MERRNI PERTUSINE

Ndiqui gjithmonë këshillat e mjekut tuaj në lidhje me dozat e Pertusine që duhet të merrni dhe shikoni gjithnjë udhëzimet e përshkruara në etiketën e barit. Dozat e zakonshme përshkruhen më poshtë.

Indikime dozimi:

Të rriturit: 1 lugë gjelle, 3 herë në ditë.

Fëmijët: ½ - 1 lugë çaji, 3 herë në ditë.

Për fëmijët nën 4 vjeç nuk rekomandohet përdorimi dhe duhet konsultuar mjeku.

Në qoftë se simptomat zgjasin më shumë se 1 javë gjatë përdorimit të shurupit, duhet të konsultohet mjeku.

Në qoftë se keni marrë më shumë Pertusine

Mos merrni më shumë Pertusine sesa rekomandimi i mjekut tuaj. Nuk ka raportime për simptoma nga mbidozimi i Pertusine.

Në qoftë se harroni të merrni Pertusine

Në qoftë se harroni të merrni Pertusine, merrni dozën tuaj sa më shpejt që të kujtoheni, përveç rastit kur ka ardhur koha që të merrni dozën pasardhëse. Përdorni dozat në kohën e duhur.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e rasteve jo. Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ju shqetëson ndonjë efekt anësor. Efektet anësore të Pertusine janë shumë të rralla. Janë raportuar shqetësime gastrointestinale.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PERTUSINE

Mbajeni larg fëmijëve!

Mos e përdorni Pertusine pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.

Ruajeni në temperaturë më të ulët se 25°C!

Ruajeni shurupin nga dielli dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Pertusine

Lëndët aktive janë ekstrakti fluid i timusit (listre) dhe bromuri i kaliumit.

1 g shurup përmban 120 mg ekstrakt fluid timusi (listre) dhe 10 mg bromur kaliumi.

Përbërësit e tjerë janë: etanol 96%, metilhidroksibenzoat (nipaginë), esencë citri, sukrozë, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me një shishe qelqi 100 g.

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:



Mund të merret pa recetën e mjekut.



Përmbajtja.



Kujdes.



Shurup.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Maj 2014.